

UDHËKRYQET E FEMRËS KRIJUESE RRETH VETVETES

Të flasësh për femrën krijuese në mjedisin tonë dhe vendin që ajo zë në rrjedhat bashkëkohore të krijimtarisë artistike, nuk është një çështje që duhet të shtrohet, madje të kërkohet që të thuhet diçka më shtruar nga vetë ato, vetëm në kohën e festës së tyre — 8 Marsit. Por, ja, pikërisht kur e ndjemë se kjo festë po troket në dyert tona, atëherë si më shumë preokupohemi rreth tyre. Është gjithashtu e vërtetë se bëhen përpjekje të mëdha që ato të përkrahen dhe të afirmohen për herë e më shumë në çdo kohë. Madje, ato kanë mundësi shumë të mëdha që të mendojnë edhe më shumë rreth vetvetes, ngase ato më së miri do ta vlerësonin pozitën e tyre.

Këtë herë pikërisht për disa aspekte të pozitës së femrës krijuese në Kosovë dhe përpjekjet e preokupimet e tyre krijuese në pasurimin e krijimtarisë artistike biseduam me Fehime Selimin (poete) dhe Vesta Nurën (piktore dhe njëherit gazetare në sektorin e artit figurativ në gazetën «Rilindja»).

Nr. 10
10 mars 1984

FEHIME SELIMI:

MË BRENGOS HESHTJA E SHOQEVE

Kohët e fundit fare pak femra po i përkushtohen krijimtarisë letrare, gjë që s'më vjen aspak mirë, sepse sot e gjithë ditën mendoj se cilësia kërkohet në sasi, e ç'cilësi e vlerave ideoartistike të kërkohet aty ku defilojnë pesë—gjashtë emra krijuesesh që merren më seriozisht me këtë punë. Pra, ato sot mund të numërohen në gishtërinj. Shumë prej këtyre femrave që e trasuan të parat këtë rrugë, krijuan familje dhe gradualisht të hutuara nga përditshmëria heshtën. Më brengos heshtja e këtyre shoqeve, por njëkohësisht i gëzohem paraqitjes së çdo emri të ri, gjithnjë me dëshirë që midis tyre të lindë një Adelinë, një Elena Kadare apo një Natasha Lako. Dhe pse jo, unë thellësisht besoj se kemi talente, por me to duhet të punohet dhe të përkrahen dhe një herë e përgjithmonë të thyhet botëkuptimi se femra nuk mund të krijojë vlera po aq të rëndësishme sa edhe mashkulli. Në një bisedë njëra prej shoqeve që dikur shkruante më tha se të

përkundësh djepin është poezi më vete. Pajtohem plotësisht me të, por më duhet të them se është poezi për të cilën gjithësi duhet të shkruhet një tjetër poezi, pra poezi për poezinë e saj të jetës. Them kështu sepse 12 përmbledhje poezish janë shumë pak për dyzet e sa vjet të krijimtarisë në liri, e të mos flasim për prozën e shkruar nga femra jonë, për të cilën, siç tha një krijues yni, sot e atë ditë ka mbetur «thembër Akili» në letrat tona.

Përndryshe, edhe unë si krijuese jam përpjekur që ta jap kontributin tim. Në vargjet e mia jeton një fëmijëri e derdhur rrugëve të vendlindjes, një botë e largët e prapë aq e afërt që evokohet përmes kujtimeve, një kohë përplot rrëfime që jetojnë në formë fatesh e tregimesh të Rthyera gati në legjendë, që në poezinë time marrin frymë përmes simboleve. Gjyshi, kulla e lumi, një lumë që rrjedh pandërprerë e simbolizon vazhdimësinë e revolucionit deri në ditë tona — janë simbole që flasin për të kaluarën e largët e të afërt në emër të së nesërme, që flasin për një dashuri që vazhdon e s'ndalet si jeta... Në vargun tim frymëzimi del si diçka që duhet të thu-



Fehime Selimi, poete

het pa tjetër, sepse mendoj se momenti i frymëzimit të sinqertë dhe mënyra e transponimit të këtij frymëzimi është komponenta kryesore e aktit të krijimit. Ky frymëzim është shqetësimi i brendshëm që i duhet poetit, vlimi shpirtëror, lufta e hapur me vetveten — nga e cila lindi vargu si pasojë. Për të gjitha këto shkruaj nga një këndvështrim i posaçëm, ta quaj ashtu «femëror». Në përmbledhjen time më të re një cikël i tërë i kushtohet femrës sonë nëpër kohë, sakrificës dhe vetëmohimit të saj për një të ardhme më të mirë.